



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

03.08.2011

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 45 të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit merr këtë:

## V E N D I M

***Mbyllet rasti me numër protokollit AKK- D.P.-03-3120/11, i dyshuar për Konflikt Interesi për zyrtarin z.Mujë Rugova –Rektorë i Universitetit të Prishtinës***

## A r s y e t i m

Në rastin e shqyrtuar për Konflikt Interesi me numër protokollit AKK-D.P.-03-3120/11, është vërtetuar se nuk ka prova të mjaftueshme që argumentojnë gjendjen e konfliktit të mundshëm të Interesit, Agjencia kundër Korrupsionit ka konstatuar se z.Mujë Rugova, Rektorë i Universitetit të Prishtinës, në të njëjtën kohë është edhe Anëtarë i Bordit Udhëheqës në Korporatën Energjitike të Kosovës-KEK.

Pas mbledhjes së Provave dhe shqyrtimit me kujdes të gjendjes reale lidhur me ushtrimin e dy funksioneve në të njëjtën kohë nga zyrtari z.Mujë Rugova është konstatuar se nuk paraqet Konflikt të Interesit dhe mos pajtueshëmeri në ushtrimin e funksionit publik të paraparë sipas nenit 17.A.2 Të Ligjit Nr.03/L-155, Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr 02/L-133 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorit të DP-së
- Zyrtari përgjegjës
- Zyrtari ndihmës

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteti

